

VENDIM
Nr. 298, datë 18.11.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HIDROCENTRALI CANGONJ” SHPK PËR
HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NR. 210, SERIA PV13K, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
ERE-s NR. 106, DATË 1.10.2013**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, germa “dh”; nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, germa “d”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1948/2 prot., datë 10.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hidrocentrali Cangonj’ sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nr. 210, seria PV13K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 1.10.2013”, konstatoi se:

- Shoqëria “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 210, seria PV13K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 106, datë 1.10.2013, për një afat 30-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 508/1 prot., datë 26.4.2022, shoqëria ka bërë me dije se për arsye objektive të pavarura nga vullneti i koncesionarit, ky HEC nuk është ndërtuar dhe vënë në operim, për pasojë nuk ka prodhuar ndonjëherë dhe nuk prodhon energji elektrike. Në këto rrethana shoqëria ka kërkuar, konform legjislacionit në fuqi, nisjen nga ERE të procedurës për heqjen e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Cangonj”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 1.10.2013.

- Me shkresën nr. 508/2 prot., 18.5.2022, ERE njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi kërkesën e shoqërisë, duke kërkuar dhe qëndrimin e saj në rast se ekziston ndonjë rrethanë për të refuzuar kërkesën e shoqërisë për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, përndryshe ERE do të vijojë me vendimmarrjen përfundimtare për sa kërkuar nga shoqëria. Deri më sot nga MIE nuk ka pasur asnjë kthim përgjigjeje.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124, datë 31.5.2022, janë përcaktuar pagesat rregullatore të vitit 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, nga ku rezulton se shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. i është caktuar pagesa e rregullimit 100,000 lekë për licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria është njoftuar për këtë detyrim me anë të shkresës së ERE-s nr. 1256 prot., 21.7.2022. Më tej, me shkresën nr. 508/3 prot., datë 1.8.2022, ERE ka sqaruar shoqërinë se për të vijuar me procedurën përkatëse administrative sipas kërkesës së saj, duhet të shlyejë më parë këtë detyrim.

- Shoqëria ka shlyer pagesën rregullatore të vitit 2022 dhe në kushtet kur ajo ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s dhe nga MIE nuk është bërë me dije ndonjë rrethanë që mund të çonte në refuzimin e kërkesës së shoqërisë, vlerësohet që të vijohet me pranimin e kërkesës.

- Në nenin 7, paragrafi i dytë, i rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017 parashikohet: në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9, të kësaj rregulloreje.

- Në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, legjislacioni në fuqi, i jep ERE-s të drejtën ligjore për t’u shprehur me një vendim miratimi pa kaluar më parë në fillimin e procedurës.

- Me hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s për heqjen e licencës nr. 210, seria PV13K, kjo e fundit e humbet fuqinë juridike.

- Në pikën 3, të nenit 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është parashikuar se në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes apo furnizimit, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve, ERE, bazuar në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së licencës, vendos një nga masat e përkohshme të përcaktuara në këtë nen.

- Për sa më sipër parashikuar, duke qenë se vepra nuk ka filluar ndërtimin dhe nuk është prodhuar asnjëherë energji elektrike nga ky central, nuk ka asete që i shërbejnë ushtrimit të kësaj veprimtarie ndaj nuk mund të vendoset asnjë nga masat e përkohshme të parashikuara në ligj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Hidrocentraliu Cangonj” sh.p.k., për heqjen e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 210, seria PV13K, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 106, datë 1.10.2013.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca nr. 210, seria PV13K humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Hidrocentraliu Cangonj” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT

Maksim Shuli